

*Imami, Shejkhu i nderuar,  
Muhadithi  
Muhamed Nasirudin El Albani*

*Pozita e  
Sunetit në  
Islam*

**Titulli: *Pozita e Sunetit në Islam***

**Autori: *Imami, Shejkhu i nderuar, Muhadithi***

***Muhamed Nasirudin El Albani***

**Përktheu: *Ylli Rama***

**Redaktoi: *Sashenka Jaupi***

**Faqosja dhe kopertina: *Rajan Alliu***

**Boton: Qendra “*Udha e Besimtarëve*”<sup>©</sup>**

**Tiranë 2012**

*Parathënie*

Falënderimi i takon vetëm Allahut, paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të dërguarin e Tij, familjen dhe shokët e tij, dhe mbi të gjithë ata që e ndjekin atë.

Kjo është një ligjëratë që e kam mbajtur në Doha, kryeqytetin e Katarit, në muajin e begatë të Ramazanit, në vitin 1392 hixhri (1972). Disa vëllezër më dhanë idenë që ta botoja, sepse ka dobi të madhe, në një kohë që muslimanët kanë shumë nevojë për të tilla trajtesa. Ndaj, duke iu përgjigjur kërkesës së tyre, vendosa ta botoj, në mënyrë që të ketë sa më shumë dobi. Kemi shtuar në të disa shtjellime në mënyrë që ta ndihmojnë lexuesin e nderuar që ta ketë më të lehtë përvetësimin e pikave kryesore. Shpresoj tek Allahu i Lartësuar që të më regjistrojë tek ata që e mbrojnë fenë e Tij dhe ndihmojnë sheriatin, si dhe të më shpërblejë për këtë kontribut.

Vërtetë Ai është më Bujari!

*Damask, më 22 muharrem, 1394 hixhri  
(15/02/1974)*

*Sqarimi i idesë se Kurani nuk ka nevojë për Sunetin*

Falënderimet dhe lëvdatat i takojnë vetëm Allahut, Atë e falënderojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Ai prej vetes dhe punës sonë të keqe! Atë të cilin e udhëzon Zoti nuk mund ta humbë askush, ndërsa atë që Ai e lë në humbje nuk mund ta udhëzojë askush përveç Tij.

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, i Vetëm pa ortak apo rival; ashtu siç dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij.

Allahu i Lartësuar thotë:

***“O ju që besuat, jini të devotshëm ndaj Allahut me një devotshmëri të vërtetë dhe mos vdisni ndryshe vetëm se duke qenë muslimanë.”***  
(Âl Imrân, 102)

***“O ju njerëz! Kijeni frikë Zotin tuaj që u ka krijuar prej një njeriu të vetëm, dhe prej tij krijoji palën (shoqen) e tij, e prej të dyve u shtuan shumë burra e gra. Dhe kijeni frikë Allahun, me emrin e***

**të Cilit përбетoheni; ruajini lidhjet farefisnore, se vërtet Allahu është Mbikëqyrësi juaj.”** (En-Nisâ, 1)

**“O ju besimtarë, përmbajuni mësimëve të Allahut dhe thoni fjalë të drejta. Ai (Allahu) ju mundëson të bëni vepra të mira dhe u shlyen mëkatet tuaja. Kush i bindet Allahut dhe të dërguarit të Tij, ai ka arritur një fitore të madhe.”**  
(El-Ahzâb, 70-71)

Më tej, themi se fjala më e drejtë është fjala e Allahut; udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të); punët më të këqija janë sajесat në fe; çdo sajесë është bidat; çdo bidat është humbje dhe çdo humbje e ka vendin në Zjarr.

Unë mendoj se nuk do kem mundësi që të parashtoj përpara këtyre njerëzve fisnikë –duke pasur parasysh se në mesin e të pranishmëve ka dijetarë të mëdhenj dhe profesorë të nderuar – diç që nuk e dinë ata. Nëse ajo që mendoj dhe them është e saktë dhe në vendin e duhur, atëherë më mjafton që të jem vetëm një përkujtues, duke zbatuar fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Përkujto,**

**sepse përkujtimi u bën dobi besimtarëve.”** (Edh-Dhârijât, 55)

Fjalimi im në këtë natë të begatë të Ramazanit nuk ka të bëjë me sqarimin e mirësive të këtij muaji, apo dispozitave të tij, apo mirësisë që ka namazi i natës në të, apo aspekteve të ngjashme që përmendin në këto net vaizët dhe ata që orientojnë njerëzit rreth gjërave që u bëjnë dobi agjëruesve dhe u kthehen atyre me mirësi dhe begati. Në fakt, kam zgjedhur që fjalimi im të jetë rreth një çështjeje shumë të rëndësishme, e cila është një prej bazave të sheriatit: kjo temë do të jetë rreth rëndësisë së Sunetit në Islam.

*Raporti i Sunetit me Kuranin*

Të gjithë jeni në dijeni se Allahu i Lartësuar e ka zgjedhur Muhamedin (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) me profetësinë e Tij, si dhe e ka dalluar me Zbulesën. I zbriti librin – Kuranin Fisnik – dhe, një ndër urdhëresat ishte që t’ua sqaronte atë njerëzve, siç lexojmë në këtë varg: **“Ty ta zbritëm Kuranin që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre.”** (En-Nahl, 44)

Ajo që mendoj është se sqarimi i përmendur në këtë varg fisnik ndahet në dy lloje:

I pari: *Komunikimi i fjalëve dhe i fjalive të tij (Kuranit) në mënyrë të saktë dhe të qartë*, duke mos fshehur asgjë nga ai, por përcjellja e tij te umeti ashtu siç e ka zbritur Allahu i Lartësuar në zemrën e Muhamedit (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të). Ky është qëllimi i vargut: **“O ti i Dërguar! Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd.”** (El-Mâide, 67) Në lidhje me këtë, Aishja (Allahu qoftë e kënaqur prej saj) ka thënë se “ai i cili u thotë se Pejgamberi (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) ka fshehur diçka për të cilën ka qenë i urdhëruar që ta komunikojë, dijëni se ka bërë një shpifje të madhe ndaj Allahut”, dhe më pas citoi vargun që përmendëm më lart. Këtë e shënon Buhariu dhe Muslimi.

Në përcjelljen e imam Muslimit thuhet: “Nëse i dërguari i Allahut (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) do të fshihte diçka nga ajo që është urdhëruar të kumtojë, do të fshihte fjalën e Allahut të Lartësuar: **“(Përkujto) Kur i the atij që Allahu e kishte shpërblyer (me besim) e edhe ti i pate bërë mirë: ‘Mbaje bashkëshorten tënde dhe**

**ki frikë nga Allahu!’ Ti e mbaje fshehtë në vete atë që Allahu do ta zbulonte dhe u frikësoheshe njerëzve, por më e drejtë është që t’i frikësohesh Allahut.”** (El-Ahzâb, 37)

I dyti: Sqarimi i kuptimit të fjalëve dhe fjalive, ose sqarimi i ndonjë vargu kuranor që umeti ka nevojë për sqarimin e tij. Më së shumti kjo ndodh në rastin e atyre vargjeve që janë të përgjithshme (implicite) apo të pa specifikuara, dhe këto sqarohen dhe specifikohen nëpërmjet fjalës, veprës apo miratimit të tij (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të).

*Domesdeshmëria e Sunetit për të kuptuar  
Kuranin*

Fjala e Allahut të Lartësuar: **“Vjedhësit dhe vjedhëses prijani duart”** (El-Mâide, 38) është shembulli më i mirë për këtë. *Vjedhësi* (në këtë rast) është një term i përgjithshëm, ashtu siç është edhe *dora*. Kështu, është pikërisht Suneti i cili shpjegon se për cilin vjedhës bëhet fjalë; duke cilësuar si vjedhës atë person që vjedh diçka në



vlerën e një çerek dinari<sup>1</sup> e sipër. Profeti (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) saktëson: *“Dora pritët vetëm nëse vidhet një çerek dinari e sipër”*. Këtë hadith e shënon Buhariu dhe Muslimi.

Gjithashtu, praktikën se si dhe në cilin vend pritët dora e ka sqaruar vepra e Pejgamberit (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) ose e sahabëve, dhe, miratimi që ai u ka bërë veprës së tyre. Sahabët ia pritnin dorën vjedhësit tek kyçët, siç na bëhet e ditur kjo nga librat e hadithit. Suneti ka sqaruar përkufizimin e dorës në vargun ku përmendet dispozita e tejemumit: ***“dhe me të fërkoni fytyrat dhe duart tuaja”*** (El-Mâide, 6), duke pasur për qëllim me *duar*, majat e gishtërinjve e deri te kyçët, siç e lexojmë në thënien e Pejgamberit (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të): *“Tejemumi është fërkimi i fytyrës dhe i duarve deri në kyçe”*.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Bëhet fjalë për dinarin e floririt që ka qenë në atë kohë, që në valutën tonë i bie 4 gr. e një çerek flori 24 karatësh, që nëse do e kthenim në valutë del 4.25 x 50\$ (që është grami i 24 karatëshit) = 212\$ - shën. i përkthyesit.

<sup>2</sup> Ahmedi, Buhariu, Muslimi dhe të tjerë; nga hadithi i Amar ibn Jasirit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij).

Në vazhdim do përmendim edhe disa vargje të tjera kuranore ku nuk mund të kuptohet tërësisht qëllimi i duhur që ka pasur Allahu i Lartësuar, përveçse nëpërmjet Sunetit.

- i. Fjala e Allahut: ***“Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me padrejtësi, atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë në rrugë të drejtë”*** (El-En’âm, 82). Shokët e Profetit (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) fjalën *padrejtësi* në këtë varg e kuptuan përgjithshëm, që përfshin çdo padrejtësi, edhe nëse është e vogël, ndaj dhe këtë shqetësim e shprehën duke thënë: – O i Dërguari i Allahut, cili prej nesh nuk e ka përzier besimin e tij me padrejtësi!? – Ai (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) u tha: – ***“Nuk është ajo për qëllim, por shirku. A nuk e keni dëgjuar fjalën e Lukmanit: – Me të vërtetë shirku është një padrejtësi e madhe?”***<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Buhariu, Muslimi dhe të tjerë.

- ii. Sërish fjala e Allahut të Lartësuar: **“Kur të jeni në udhëtim e sipër, nuk është mëkat për ju të shkurtoni namazin, nëse frikësoheni se jobesimtarët do t’ju shkaktajnë ndonjë të keqe.”** (En-Nisâ, 101) Në pamje të parë ky varg na jep të kuptojmë se shkurtimi i namazit kur je në udhëtim është i kushtëzuar me frikën, ndaj dhe disa prej sahabëve e kanë pyetur të dërguarin e Allahut (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) duke i thënë: – Pse ne e shkurtojmë (namazin) duke qenë se tani jemi të sigurt? – Ai u tha: **“Jo. Është një lëmoshë që ua ka dhënë Allahu, prandaj pranojeni lëmoshën e Tij”**.<sup>4</sup>
- iii. **“Ju u janë ndaluar (t’i hani): ngordhësira dhe gjaku.”** (El-Mâide, 3) Suneti ka sqaruar se ngordhësira si: karkaleci, peshku, shpretka dhe mëlçia (që janë prej gjaku) janë të lejuara. Profeti (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) thotë: **“Na janë lejuar dy lloje**

---

<sup>4</sup> Muslimi.

ngordhësirash e dy lloje gjaku: karkaleci dhe peshku (me të gjithë llojet tij) si dhe shpretka dhe mëlçia”.<sup>5</sup>

- iv. ***“Thuaju: ‘Në atë që më është shpallur (në Kuran) nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi, përveç në qoftë se ai (ushqimi) është ngordhësirë, gjak i derdhur ose mish derri; ai është i ndytë, ose mëkat që është therur jo në emër të Allahut’.*”** (El-Enâm, 145) Por Suneti ka ndaluar edhe gjëra të tjera që nuk janë përmendur në këtë varg, si, për shembull: *“Çdo kafshë mishngrënëse dhe çdo shpend me kthetra është i ndaluar (haram)”*. E, në lidhje me këtë temë ka hadithe të tjera që ndalojnë për këtë, siç është fjala e tij (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) ditën e Hajberit, ku tha: *“Vërtetë Allahu dhe i Dërguari i tij ju ndalojnë që*

---

<sup>5</sup> Bejhekiu dhe të tjerë, si fjalë e Pejgamberit. Përcillet edhe si fjalë e një sahabiu, dhe zinxhiri i transmetimit është i saktë. Kështu, kjo merr gjykimin sikur e ka thënë vetë Pejgamberi (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të), sepse është prej atyre gjërave që nuk mund të flitet për to nga mendja.

*t'i hani gomarët shtëpiakë, sepse është mëkat*".<sup>6</sup>

- v. ***"Thuaj: 'Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që Allahu i krijoi për robërit e Tij'?"*** (El-Arâf, 32) Edhe në këtë rast Suneti na ka treguar se ka nga ato stoli që janë të ndaluara. Është saktësuar nga Pejgamberi (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) se ai ka dalë një ditë para shokëve të tij; në një dorë kishte mëndafshin e në dorën tjetër floririn, dhe tha: ***"Këto të dyja janë të ndaluara për meshkujt e umetit tim dhe të lejuara për femrat"***.<sup>7</sup>

Për sa më sipër, del në pah rëndësia që ka Suneti në legjislacionin islam. Nëse ne do i vërejmë me kujdes shembujt e përmendur, duke mos folur për shembujt e tjerë që nuk i cekëm, bindemi se nuk mund ta kuptojmë Kuranin sa dhe si duhet vetëm se me ndihmën e Sunetit.

---

<sup>6</sup> Buhariu dhe Muslimi.

<sup>7</sup> Hakimi, i cili edhe e ka saktësuar bashkë me disa të tjerë. Shembuj të tillë ka shumë, që janë të njohur për ata që kanë dije rreth hadithit dhe fikhut.

Në shembullin e parë sahabët e kuptuan sipërfaqësisht fjalën *padrejtësi*, megjithëse ata (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre) ishin ashtu siç i ka cilësuar Ibn Mesudi kur ka thënë se “ata kanë qenë më të mirët e këtij umeti; kanë pasur zemrën më të kulluar dhe më të thelluarit në dije, dhe më me pak teklif”. Por, megjithatë ata gabuan në kuptimin e vargut dhe, sikur Pejgamberi (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) të mos i korrigjonte dhe të mos i drejtonte në kuptimin e drejtë të fjalës *padrejtësi*, se qëllimi është për *shirkun*, edhe ne do i ndiqnim ata në gabimin e tyre; porse Allahu i Lartësuar na ruajti prej një gjëje të tillë me mirësinë e udhëzimit të tij (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të).

Ndërsa te shembulli i dytë, sikur të mos ishte hadithi që përmendëm, do të ishim në dyshim, së paku për çështjen e shkurtimit të namazit në udhëtim, sikurse lë të kuptohet në pamje të parë vargu kuranor, pra siç u shkoi ndërmend disa prej sahabëve. Po të mos e shikonin të dërguarin e Allahut (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) duke e shkurtuar, e ta shkurtonin me të kur ata ishin të sigurt, nuk do e përftonim këtë sqarim.

Kurse në shembullin e tretë, sikur të mos ishte përsëri hadithi do të bënim të ndaluara disa ushqime që i kemi të lejuara, si: karkaleci, peshku, mëlçia dhe shpretka.

Ndërsa te shembulli i katërt, sikur të mos ishin hadithet që ne përmendëm do të bënim të lejuara gjërat të cilat Allahu i ka ndaluar përmes gojës së Pejgamberit të tij, siç është rasti me floririn dhe mëndafshin. Duke u nisur nga këta shembuj, disa prej selefëve kanë thënë se “Suneti është gjykatësi i Kuranit”.

*Devijimi i atyre që mjaftohen vetëm me Kuranin*

Është për të ardhur keq që disa interpretues të Kuranit, si dhe disa shkrimtarë bashkëkohorë, kanë shkuar me mendimin se lejohen gjërat që ne përmendëm në shembujt e mësipërm, duke u bazuar vetëm te Kurani. Në kohën tonë ka dalë një grup që quhen *kuranijunët*, të cilët e interpretojnë Kuranin sipas tekave dhe mendjeve të tyre, duke lënë mënjanë Sunetin e saktë. Për ta Suneti është një ndjekës i tekave të tyre: nëse një pjesë e Sunetit i plotëson tekat e

tyre, atëherë kapen pas saj. Pejgamberi (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) na ka treguar për këta persona në një hadithi të saktë, ku thotë: *“Të mos e pësojë ndonjëri prej jush, duke qenë i mbështetur në kolltuk e tij, që i vjen një urdhër për të cilin unë kam urdhëruar ose ndaluar e të thotë: ‘Nuk e di! Ndjekim atë që gjejmë në librin e Allahut’.”*<sup>8</sup>

Po ashtu, prej gjërave që është për të ardhur keq është se një shkrimtar i nderuar ka shkruar një libër rreth legjislacionit islam dhe besimit të tij, ku, në parathënien e librit ka përmendur se kur e ka shkruar librin nuk ka pasur referenca të tjera përveç Kuranit!

Ky hadith i saktë tregon në mënyrë të prerë se legjislacioni islam nuk është vetëm Kurani, por edhe Suneti. Ai i cili kapet pas njërit duke lënë tjetrin, ai nuk është kapur pas asnjërit prej tyre,

---

<sup>8</sup> E shënon Tirmidhiu. Në një version tjetër lexojmë: *“Atë që gjejmë në të (Kuran) nga të ndaluarat, ndalohemi. Dijeni se me të vërtetë mua më është dhënë Kurani, por edhe diçka e ngjashme me të.”* Në një tjetër: *“Dijeni se ndalesa e të Dërguarit të Allahut është e njëjtë me atë që ka ndaluar Allahu”.*



sepse secili syresh urdhëron për ndjekjen e tjetrit, siç ka thënë i Lartësuar: **“Ai i cili i bindet të Dërguarit i është bindur Allahut.”** (En-Nisâ, 80)

**“Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të të zgjedhin ty për të gjykuar për konfliktet mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe, (derisa) të të binden sinqerisht.”** (En-Nisâ, 65)

**“Kur Allahu ka vendosur për një çështje, ose i dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohej) asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të kërkojnë ndonjë zgjidhje tjetër. E kush e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës.”** (El-Ahzâb, 36)

**“Çfarë ju jep Pejgamberi, merreni, e çfarë ju ndalon, përmbajuni.”** (El-Hashr, 7)

Me rastin që përmendëm këtë varg, më pëlqen shumë ajo që tregohet prej Ibn Mesudit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), ku thuhet se u

takua me një grua, e cila i tha: – A ti je ai i cili thua se Allahu i ka mallkuar gratë që i heqin vetullat dhe gratë që ua heqin vetullat të tjerave (bëhet fjalë për një hadith në lidhje me këtë çështje)?! – Ai i tha: – Po. – Ajo ia ktheu: – Unë e kam lexuar librin e Allahut që nga fillimi e gjer në fund dhe nuk e kam gjetur atë që thua ti! – Ai i tha: – Nëse ti do e kishe lexuar, do e kishe gjetur. A nuk e ke lexuar fjalën e Allahut: **“Çfarë ju jep Pejgamberi, merreni, e çfarë ju ndalon, përmbajuni”!**? – Ajo i tha: – Patjetër! – Ai i tha: – Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) duke thënë: **“Allahu e ka mallkuar atë grua që i heq vetullat e saj”**.<sup>9</sup>

*Për të kuptuar Kuranin nuk mjafton vetëm dija mbi gjuhën*

Duke marrë parasysh atë që trajtuam, është e qartë se nuk ka mundësi askush, sado filolog i madh të jetë në gjuhën arabe dhe letërsinë e saj, të kuptojë Kuranin Fisnik vetëm nëpërmjet gjuhës, pa u mbështetur në kuptimet që i ka dhënë Suneti i

---

<sup>9</sup> Buhariu dhe Muslimi.

Pejgamberit (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të); përmes e fjalëve apo veprave. Ky njeri nuk mund të jetë më i ditur në gjuhën arabe sesa shokët e Pejgamberit (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të), të cilëve u zbriti Kurani në gjuhën e tyre. Sepse, në gjuhën e tyre akoma nuk ishin futur fjalët e huaja apo gabimet, e megjithatë ata gabuan në kuptimin e vargjeve që përmendëm, kur u mbështetën vetëm te kuptimi gjuhësor.

Prandaj, sa më shumë që njeriu është i ditur rreth Sunetit, aq më shumë është i prirë të kuptojë Kuranin e të nxjerrë rregulla prej tij; në krahasim me një tjetër i cili nuk ka njohuri rreth Sunetit. E si mund të jetë puna më atë që nuk ka mësuar për Sunetin e nuk i kthehet fare atij?!

Kështu që, prej rregullave bazë që kanë rënë në ujdë të gjithë dijetarët, është se Kurani shpjegohet me Kuran dhe Sunet<sup>10</sup>, e më pas me fjalët e sahabëve e kështu me radhë.

---

<sup>10</sup> Nuk themi ashtu sikurse është bërë e njohur për shumë njerëz të dijes, që: Kuranin e shpjegojmë me Kuran, e nëse nuk e gjejmë shpjegimin e tij në Kuran, i kthehemi Sunetit. Këtë do e shpjegojmë edhe më tej në fund të kësaj broshure,

Kësisoj na bëhet i qartë devijimi i atyre dijetarëve që janë marrë me filozofi<sup>11</sup>, si ata të vjetrit ashtu edhe të rinjtë syresh. Në këtë mënyrë ata kundërshtuan besimin e selefëve, të mos flasim pastaj për kundërtinë që kanë në lidhje me gjykimet: e gjithë kjo është si pasojë e largimit nga Suneti, si dhe rrjedhojë e dhënies përparësi mendjeve e tekave të tyre në lidhje me vargjet e Kuranit që flasin për cilësitë e Allahut. Diçka shumë e bukur është përmendur në librin *Sherh Akidetu Tahavije* (f. 212), ku thuhet: “Si mund të flasë për çështjet bazë të fesë dikush i cili nuk e merr dijen nga Kurani dhe Suneti, por nga X-i dhe Y-ni? E nëse ai pretendon se e merr dijen nga libri i Allahut, shpjegimin e tij nuk e merr nga hadithi i të Dërguarit (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të). Ai nuk e hedh shikimin te hadithi e as te fjalët e sahabëve e tabiinëve, urtësi që na janë përcjellë nga përzgjedhja që kanë bërë dijetarët e njohur, të cilët nuk na kanë përcjellë vetëm fjalët e Kuranit,

---

kur të flasim për hadithin e Muadh ibn Xhebelit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij).

<sup>11</sup> Që e kanë tepruar në këtë drejtim, duke i dhënë më shumë vend sesa duhet filozofisë – *shën. i redaktorit*.

por dhe shpjegimin e tij. Ata nuk e mësonin Kuranin si fëmijët, por mësonin kuptimet e tij. Ai i cili nuk ndjek rrugën e tyre, atëherë ai flet nga mendja e tij, dhe ai që flet nga mendja e tij dhe nga çfarë pretendon se është fe e Allahut, duke mos e marrë këtë dije nga Kurani, ai është gjynahqarë, edhe nëse ia qëllon. Kurse ai i cili e merr fenë nga Kurani dhe Suneti, ka shpërblim edhe nëse gabon; ndërsa nëse ia qëllon, shpërblimin e ka të dyfishtë.”

Më pas, në faqe 217 shkruan: “Obligimi është ky: ne duhet t’i dorëzohemi plotësisht të Dërguarit të Allahut (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të), si dhe t’i bindemi urdhrimit të tij. Ta marrim fjalën e tij duke e pranuar e vërtetuar pa e kundërshtuar me fantazi të kotë, të cilën e quajmë logjikë, apo të bartim polemika e dyshime, apo t’u japim përparësi mendimeve të njerëzve dhe asaj që qarkullon në mendjet e tyre. Në e besojmë atë (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) në gjykimin e tij; i dorëzohemi plotësisht dhe i bindemi, ashtu siç e besojmë Atë që e dërgoi me cilësi si: adhurimi, përulja, mbështetja dhe pendimi.”

Fjala përmbledhëse është se, muslimanët e kanë për detyrë që të mos bëjnë asnjë dallim ndërmjet Kuranit dhe Sunetit, për nga aspekti i të qenurit detyrim mbështetja të të dy këto dy burime, si dhe të ndërtohet fenë mbi to njëkohësisht; sepse të këto dy burime është siguria që nuk të lë të devijosh majtas ose djathtas; duke u ruajtur fort edhe nga rikthimi në humbje, siç e ka shprehur një gjë të tillë i Dërguari i Allahut (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të): *“Ju kam lënë dy gjëra; nuk do humbisni nëse do të kapeni pas tyre: Librin i Allahut dhe Sunetin tim. Këto të dy nuk do ndahen derisa të vijë në liqenin tim ditën e gjykimit”*.<sup>12</sup>

### *Vërejtje e rëndësishme*

Pasi përmendëm gjithë këtë, besoj se është normale të pohoj se Suneti, i cili ka këtë rëndësi të madhe në legjislacion, është vërtetuar nga Profeti (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) me rrugët akademike dhe me zinxhirë transmetimi të

---

<sup>12</sup> E shënojnë Maliku dhe Hakimi, me zinxhir transmetimi të mirë (*hasen*).

saktë, gjë që është e njohur për dietarët që merren me studimin e hadithit dhe dijen rreth personave që e përcjellin atë. Nuk bëhet fjalë për ato hadithe që gjenden në brendësi të librave të *tefsīr-it*<sup>13</sup>, apo *fikh-ut*<sup>14</sup>, apo në libra që janë për *nxitje* dhe *vërejtje* e të tjerë të kësaj natyre, sepse brenda tyre ka shumë hadithe të dobëta e të shpikura/sajuara. Por, Islami është i pastër nga kjo kategori hadithesh, siç është rasti me hadithin për Harutin dhe Marutin dhe me historinë e Garanikëve, ku unë kam bërë një shkrim të posaçëm në lidhje me këtë histori, e cila është e botuar dhe kam treguar kotësinë e saj.<sup>15</sup> Gjithashtu kam punuar për përzgjedhjen e shumë haditheve te libri im *Silsiletu daiife uel meudua ue etheruha sejiu fil umme*, që deri tani kam arritur të mbledh rreth katër mijë hadithe<sup>16</sup> dhe, të gjitha këto

---

<sup>13</sup> Komentimit të Kuranit

<sup>14</sup> Jurisprudencës Islame

<sup>15</sup> Libri titullohet *Nesbul mexhanik fi nesfi kisatul garanik*.

<sup>16</sup> Tani numri i tyre i ka kaluar pesë mijë. Allahu na ndihmoftë që ta botojmë! (Falë Zotit, tani libri gjendet i plotë, ku shejhu – Allahu e mëshiroftë – ka mbledhur rreth 6500 hadithe – *shën. i përkthyesit*).

hadithe janë të dobëta ose të shpikura/sajuara. Deri tani janë botuar vetëm pesëqind hadithe.<sup>17</sup>

Është detyrë për njerëzit e ditur dhe në veçanti për ata që përhapin fetvatë dhe *fikh*-un e tyre, që të mos marrin guximin për të argumentuar me ndonjë hadith pa u siguruar më parë për vërtetësinë e tij; pasi, librat e *fikh*-ut, që lexohen zakonisht, janë të mbushur me hadithe që kanë probleme. Për të mos folur pastaj për ato hadithe që nuk kanë asnjë farë baze, siç dihet një gjë e tillë nga dijetarët.

Unë nisa një libër që e shoh shumë të rëndësishëm, që është i dobishëm për ata që punojnë me librat e *fikh*-ut, të cilin e kam titulluar *Hadithet e dobëta dhe të shpikura në librat bazë të fikh*-ut. Me 'librat bazë' të *fikh*-ut ka parasysh këta tituj:

- i. *El-Hidâjetu*. Vepër e El-Merginanit në *fikh*-un hanefî.

---

<sup>17</sup> Botimi i haditheve në kohë që flasim është bërë i plotë dhe libri i shejh Albanit (Allahu e meshiroftë) përbëhet nga 11 vëllime të mëdha, ku ka mbledhur rreth 4035 hadithe. Allahu e shpërbleftë imam Albanin për mundin e tij! – *shën. i përkthyesit*.

---



- ii. *El-Mudevene*. Vepër e Ibn Kasim në *fikh-un malikī*.
- iii. *Sherhul Vexhiz*. Vepër e Rafi'i në *fikh-un shafī*.
- iv. *El-Mugnī*. Vepër e Ibn Kudametu në *fikh-un hanbelī*.
- v. *Bidajetul Muxhtehid*. Vepër e Ibn Ruxhd El-Andalusit në *fikh-un mukarene*.<sup>18</sup>

Por, për fat të keq nuk më është dhënë mundësia që ta mbaroj këtë nismë, sepse revista *El-Ua'jul Islam* e Kuvajtit, e cila dha premtimin për publikimin e materialeve, pasi e pa materialin nuk e botoi.

E, meqë ky rast më iku, ndoshta, me lejen e Allahut të Lartësuar, më jepet shansi në ndonjë rast tjetër, që të përpiloj një metodologji akademike të përpiktë për vëllezërit e mi të cilët merren me *fikh-un*, që të jetë në ndihmë të tyre, si dhe t'ua lehtësojë njohjen e gradës së hadithit kurdo që të kthehen te librat kryesorë të

---

<sup>18</sup> *Fikhul-mukaren* ka të bëjë me krahasimin mes medhhebeve në një çështje të caktuar, dhe daljen në një përfundim për mendimin më të saktë – *shën. përkthyesit*.

haditheve, kthim i cili do të jetë i patjetërsueshëm; duke shpjeguar veçoritë dhe cilësitë e tyre, dhe se në cilin prej tyre mund të mbështeten. Megjithatë, Allahu është Ai i cili e jep suksesin!

*Dobësia e hadithit të Muadhrit që ka të bëjë me logjikën dhe çfarë refuzohet prej tij*

Para se ta mbyll fjalimin tim, mendoj se është e nevojshme që t'u tërheq vërejtjen vëllezërve që janë të pranishëm për një hadith që është i përhapur, i cili përmendet në librat e *usūl-it* dhe që pak kanë shpëtuar pa e përmendur këtë hadith. Duhet të tregojmë dobësinë që ka ky hadith në zinxhirin e transmetimit të tij, si dhe kontradiktat që ka me përfundimin që nxorëm nga ky fjalim, ku thamë se nuk lejohet që të bëjmë dallime në legjislacion mes Librit të Allahut dhe Sunetit, dhe se është detyrë që t'i marrim që të dy. Qëllimi është për hadithin e Muadhrit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), kur i dërguari i Allahut (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të) e dërgoi në Jemen dhe i tha:

*“Me çfarë do të gjykosh?”* – Tha: – Me Librin e Allahut. – Ai i tha: – *“E nëse nuk do e gjesh në librin e Allahut?”* – Tha: – Me Sunetin e të

Dërguarit të Tij. – Përsëri i tha: – “E nëse nuk do ta gjesh në Sunetin e tij?” – Tha: – Do të jap mendimin tim e nuk do neglizhoj. – Profeti tha: “Falënderimi i takon Allahut i Cili i jep sukses lajmëtarit të Dërguarit të Tij për atë që dëshiron i Dërguari.”

Sa i përket dobësisë që ka ky hadith në zinxhirin e transmetimit të tij, nuk është ky vendi i përshtatshëm për ta shtjelluar, por unë e kam sqaruar shumë qartë, e ndoshta jam i pari që e kam bërë një gjë të tillë, në librin që përmenda më sipër.<sup>19</sup> Por, tani do mjaftohem duke thënë se prijësi i besimtarëve për çështjet e hadithit, imam Buhariu (Allahu e mëshiroftë), për këtë hadith ka thënë: “Hadith i refuzuar”. Dhe pas kësaj, më lejohet që të sqaroj kontradiktën që përmenda pak më lart, dhe them:

Hadith i Muadhit i vendos gjykatësit një metodë për të gjykuar, e cila ka tri faza: nuk i lejohet që të gjykojë me logjikën e tij përveçse kur nuk arrin të gjejë diçka në Sunet, si dhe, nuk i lejohet të gjykojë me Sunet veçse atëherë kur nuk gjen diçka në Kuran. Kjo, sipas logjikës është

---

<sup>19</sup> *Silsiletu Daifetu uel Meudua*, nr. 885.

metodë e saktë për shumicën e dijetarëve, ndaj kanë thënë se “nëse vjen transmetimi bie poshtë logjika”. Por, për sa i përket Sunetit kjo nuk është e saktë; sepse Suneti është gjykatës ndaj Librit të Allahut dhe sqarues i tij; ai e ka detyrë që të kërkoj në Sunet edhe nëse ai mendon se mund ta gjejë atë gjykim në Kuran, pikërisht për shkak të asaj që ne trajtuam. Raporti i Sunetit me Kurani nuk është si raporti i logjikës me Sunetin, assesi; por, duhet që Kurani dhe Suneti të konsiderohen një bazë, duke mos bërë asnjëherë ndarje ndërmjet tyre, sikundërse ka treguar për këtë fjala e tij (paqja dhe nderimi i Allahut qofshin mbi të): *“Dijeni se mua më është shpallur Kurani, por edhe diçka e ngjashme me të”* – dhe ka për qëllim Sunetin. Po ashtu: *“Nuk do të ndahen ata të dy (Kurani dhe Suneti) derisa të vijnë tek unë në liqenin tim Ditën e Gjykimit”*.

Ndaj, zëvendësimi që është përmendur mes tyre nuk është i saktë, sepse tregon ndarjen midis tyre, dhe kjo është e kotë, siç e sqaruam.

Kjo është ajo çka doja të tërhiqja vërejtjen prej saj. Nëse jam i saktë, është mirësi e Allahut, e nëse kam gabuar, kjo më takon mua.

E lus Allahun që të na ruaj nga devijimi dhe prej çdo gjëje që nuk e kënaq Atë!

Lutja jonë e fundit është: falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve!

## **Përmbajtja**

Parathënie.....	<b>3</b>
Sqarimi i idesë se Kurani nuk ka nevojë për Sunetin.....	<b>4</b>
Raporti i Sunetit me Kuranin.....	<b>6</b>
Domosdoshmëria e Sunetit për të kuptuar Kuranin .....	<b>8</b>
Devijimi i atyre që mjaftohen vetëm me Kuranin.....	<b>15</b>
Për të kuptuar Kuranin nuk mjafton vetëm dija mbi gjuhën.....	<b>18</b>
Vërejtje e rëndësishme.....	<b>22</b>